



Interreg
Balkan-Mediterranean
Mo.Na



BUTRINTI

RRËFIMI FANTASTIK I JUNIA RUFINËS

Unë jam Junia Rufina dhe kam qëndruar
në qytetin e Butrintit gjatë një pjese të jetës
sime. Kur mbërrita në qytet në shekullin
e 2-të mbas Krishtit, Butrinti ishte i
famshëm për historinë e pasur shekullore
dhe ndërtimet e shumta luksoze,
për të cilat do t'ju rrëfej në vazhdim.



Ky botim, është realizuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, nën kujdesin e Znj. Rudina Zoto, Drejtor i Përgjithshëm.

Përmbajtja:

- Projekti Mo.Na - Monumente në Natyrë: Një bashkëjetesë kreative
- Butrinti dhe legjendat e themelimit të tij
- Tempulli i Asklepit
- Teatri
- Pusi i Junia Rufinës
- Peshkimi në Butrint

Botimi nuk është në shitje. Iu shpërndahet falas të gjithë të interesuarve që vizitojnë Butrintin deri në përfundim të rezervave. Ilustrimet e publikuara në këtë botim janë origjinale dhe të realizuara në kuadër të projektit Mo.Na – Monumente në Natyrë: Një bashkëjetesë krijuese.

Mbështetja financiare për hartimin dhe publikimin e këtij materiali është siguruar nga Programi Interreg Balkan - Mediterranean 2014-2020.

Projekti Mo.Na zbatohet në kuadër të Programit INTERREG Balkan - Mediterranean 2014-2020 dhe bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (ERDF dhe IPA II) si dhe nga Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.

Butrinti dhe legjendat e themelimit të tij

Butrinti i shënon fillesat e tij që në periudhën e Bronzës së Vonë (viti 1400-1100 para Krishtit), kur qyteti ishte një vendbanim i vogël peshkatarësh, i vendosur në pjesën më të lartë të kodrës.

Mbretërit molosë të shek. 4-3 para Krishtit "mburrshin" për

prejardhjen e tyre homerike duke sajuar legjenda të shumta rreth themelimit të qytetit. Origjina mitike e Butrintit përjetësohet nga poeti i oborrës, i epokës së Augustit, Virgjilit, i cili përmend Butrintin si qytetin ku hero i veprës së tij, Enea, ndaloi në udhëtimin e tij drejt Italisë dhe ku zbuloi një vendbanim të krijuar prej bashkatdhetarëve të tij nga Troja. Enea hyri në Butrintin trojan nëpërmjet "Portës Scaea" dhe në një pyll përballë qytetit takoi Andromakën.



A e diní se Asklepí,
perëndia i shërimit
dhe mjekësisë, ka qenë
shumë i respektuar në
Butrint?

Tempulli i Asklepit

Tempulli i Asklepit përbën
bërthamën e themelimit të
qytetit të mirëfilltë.

Fama që gëzonte shtrihej në një territor të gjerë dhe
tempulli vizitohej nga njerëz të shumtë, të cilët
kërkonin kurimin e sëmundjeve të ndryshme që i
shqetësonin, duke besuar edhe në vetitë shëruese të
pusit pranë faltore.

Pra, tempujt rrethoheshin nga ndërtesa me një funksion të krahasueshëm me
spitalet moderne dhe krahas cilësisë së tyre si qendra religjioze, ofronin edhe
këshilla dhe trajtim mjekësor.

Vizitorët e panumërt i kushtonin dhurata të shumta perëndisë, duke bërë që
tempulli të pasurohej vazhdimisht, duke kontribuar në ndërtimin e teatrit
apo edhe të monumenteve të tjera si Stoa (shëtitorja), e cila shërbente për
pelegrinët dhe të sëmurët, të cilët vizitonin tempullin e Asklepit.

Asklepí kishte simbol gjarpër dhe simbolika e tij trashëgohet edhe në
mjekësinë moderne! Ky simbol ruhej edhe në dyshemenë me mozaik që
dekoronte brendësinë e tempullit me figurën e gjarpërit.

A e diní që në Butrint adhuroheshin edhe perëndi të tjerë përveç Asklepit?
Ato ishin Apoloní¹, Artemísá², Athínajá³, Demetrá⁴ dhe Zeúsí⁵. Prej kultit
të tyre na është trashëguar vetëm një faltore e vogël, e cila në shek. 1-2 mbas
Krishtit është shndërruar në një Kapitolium ose një kompleks faltorësh
kushtuar perëndive kryesore romake si Jupíterí⁶, Juná⁷ dhe Mínervá⁸.

¹ Perëndia e Diellit dhe Arteve

² Perëndesha e Gjuetisë

³ Perëndesha e Dijes

⁴ Perëndesha e Natyrës dhe Gjuetisë

⁵ Perëndia kryesore e Olimpít

⁶ Zeúsí në Greqinë e Lashtë

⁷ Hera në Greqinë e Lashtë, bashkëshortja e Zeúsit, mbrojtëse e gruas dhe martesës

⁸ Athínajá në Greqinë e Lashtë

Teatri


Teatri i Butrintit rezervon shumë surpriza! Është një vepër publike e shek. 3-të para Krishtit, ndoshta i kohës së mbretit Përro i Epirit (viti 319/318 - 272 para Krishtit). Në teatër vireshin në skenë vepra të ndryshme, si drama, komedi, tragjedi. A e dini se teatri i Butrintit ka qenë në përdorim deri në shpalljen zyrtare të Krishterimit në shek. 4-t mbas Krishtit?

A e dini se krahas aktrimit në teatër kryheshin edhe akte të tjera, si për shembull ceremoni të lirim të skelleve, që ndryshe njihet me termin *manumission*?



A e dini se aktorët në teatrin antik vendosnin maska të personalizuar dhe përdornin kostume të ndryshme për të paraqitur karakteret, në mënyrë që audienca t'i identifikonte nga distanca?


Pikërisht këtu zuri vend dhe e ashtuquajtura çudia e Shën Terinit, një i krishterë vendas, që u dënua të lihej midis kafshëve të egra, të cilat nuk e sulmuan por u përulën para tij!



Pusi i Junia Rufinës

A e dini se për të shkuar në pusin e Junia Rufinës duhet të kaloni nëpërmjet Portës së Luanit?

Kjo portë u pagëzua kështu nga arkeologu italian Luigi Maria Ugolini, për shkak të tematikës së gdhendur në relief në arkitraun e saj. Pusi monumental i dhuruar prej Junias ndodhet pikërisht në të majtë të korridorit të Portës së Luanit, pranë një burimi, në një shpellë natyrore, me një kushtim të veçantë ndaj donatores bujare si “mikeshë e nimfave”. Në fakt, ky akt nuk është i rastësishëm!



Njerëzit e Antikitetit i kushtonin shumë vëmendje kultit të nimfave, të cilat ata i lidhnin me ujën, martesën dhe lindjen. Duke pasur një pozicion të ndërmjetëm midis Hyjnive dhe Njeriut, ato konsideroheshin mirëbërëse për njerëzit dhe krahës attributeve të tjera asistojnë dhe mbrojnë vajzat e reja gjatë fazës së ndryshimit të statusit të tyre nga vajza në gra. Gjithashtu, lidhja e tyre me burimet ujore, një nevojë jetësore për njeriun, i kthejnë ato në një pjesë të rëndësishme të jetës dhe ritualit të përditshëm të një individi të periudhës antike.

Peshkimi në Butrint

A e dini që peshkimi ishte një aktivitet i rëndësishëm në Butrint?

Në fakt, që në periudhën e bronzit të vonë banorët e Butrintit kanë qenë peshkatarë dhe shfrytëzonin ujërat e pasura të liqenit me midhje dhe peshk! Peshku zinte një vend të rëndësishëm në kulturën kulinare të banorëve të Butrintit.

Në Antikitetet peshkatarët kishin një status të ulët social ndaj dhe shumë aspekte të organizimit të tyre na mbeten të panjohura.

Peshkimi në Butrint realizohej të paktën në dy mënyra: me anije peshkimi në thellësi dhe në mënyrë artizanale në breg.

Peshkatarët mund të thurnin vetë rrjetat e tyre dhe mbanin gjithmonë me vete mjetet që shërbenin për këtë punë, në mënyrë që të restauronin në vend rrjetat e dëmtuara.

© Copyright:
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore - IKTK
Tiranë 2022

Të Drejtat e Riprodhimit
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore - IKTK
Parku Kombëtar Butrint

Ilustrimet në akvarel, Dizajni dhe faqosja:
Blerina Pagria

Konceptuan botimin
Era Xhaferaj, Klodjana Gjata, Marsela Plyku Demaj

Teksti
Era Xhaferaj

Për më shumë informacion mbi projektin Mo.Na:
<https://www.monumentnature.com>

